

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission  
d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Legjislatura e –II-  
**KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,**  
**ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM**  
**HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 80**  
nga mbledhja publike e mbajtur më **11.9.2007**  
kryesuar nga **Rifat Krasniç**-kryetar i komisionit  
Mbledhja filloi në orën 11,00

**Të pranishëm :**

1. Rifat **KRASNIÇ** kryetar
2. Lulzim **ZENELI** nënkryetar-I
3. Jusuf **SUTAJ**
4. Fetah **BERISHA**
5. Zyhrie **MALOKU**
6. Berat **LUZHA**
7. Selviqe **HALIMI**
8. Afrim **ARZUALLXHIU**
9. XHelal **CANZIBA**

**Munguan :**

10. Shaban **HALIMI**
11. Gazmend **MUHAXHERI**
12. Sadudin **BERISHA**
13. Goran **BOGDANOVIĆ**-nënkryetar-II-
- 14.

**TË FTUARIT : munguan**

**RENDI I DITËS U MIRATUA ME NDRYSHIM :**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit për kryesinë
3. Projektligji për parqet nacionale.
4. Të ndryshme.

## **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje.

## **Shqyrtimi i Raportit për Kryesinë**

**Kryetari** në fillim përshëndeti anëtarët e komisionit dhe pasi që konstatoi se rendi i ditës u ndryshua për shkak të mungesës së përfaqësuesve të MMPH, theksoi se raporti i këtij komisioni për vizitat në disa komuna është hartuar më herët dhe ajo përmban gjithashtu rekomandimet për seancën plenare për tu radhitur në rendin e ditës çështja mjedisore në Kosovë, ndaj pyeti anëtarët e komisionit se a janë të pajtimit për këtë raport ti dërgohet kryesisë. Komisioni nxori :

### **P Ë R F U N D I M**

- 1. Raporti i komisionit për vizitat në disa komuna MIRATOHET si dhe analiza e çështjeve mjedisore që është theksuar në këtë raport.**
- 2. Komisioni kërkon nga Kryesia e Kuvendit që çështja mjedisore në Kosovë dhe alarmimi i komunave të Kosovës për këtë problematikë , të konsiderohet si çështje urgjente dhe të futet si pikë e veçantë për seancën plenare në javën e parë të tetorit 2007.**

## **Projektligji për parqet nacionale**

**Lulzim Zeneli** hapi diskutimin rreth projektligjit në fjalë duke kërkuar nga të pranishmit deklarin përfundimtar.

**Berat Luzha** theksoi se nuk ka çka të diskutoi komisioni për këtë projekt me aq shumë paqartësi dhe kontradikta ndërministrorë. Për këtë projekt janë kompetente dy ministri, çka është e patolerueshme, sipërfaqja e propozuar e parkut “Bjeshkët e Nemuna” tek neni 6 është diskutabile dhe nuk mund të amendamentohet, dy ministrat MBPZHR dhe MMPH për çështje qenësore nuk kanë akorduar qëndrimet , përkundër qëndrimit të Qeverisë se projektligji në fjalë mbetet sugjerim nga Qeveria.

**Jusuf Sutaj** gjithashtu përkrahu këto vërejtje dhe shtoi se komisioni nuk ka mundësi të rregulloi këtë projekt sidomos sa i përket nenit 5 dhe 6.

**Lulzim Zeneli** pasi konstatoi unifikimin e mendimeve të komisionit propozoi komisionit të nxjerr një përfundim nga kjo.

**Komisioni nxori :**

### **P Ë R F U N D I M**

**Rekomandohet seancës plenare që projektligji për parqet nacionale ti kthehet Qeverisë në ripunim, në bazë të vërejtjeve të komisionit funksional.**

### **A r s y e t i m i**

Në rekomandimin me shkrim do të arsyetohet ky përfundim i komisionit në pika të shkurta.

### **Të ndryshme**

Në kuadër të kësaj pike komisioni diskutoi më tepër në aspektin e diskutimeve të lira rreth angazhimeve gjatë ditëve në vijim, sidomos në seancën plenare të radhës, ndërsa **Blerim Vela** njoftoi se prapë janë bërë disa ndryshime sa i përket vizitave të komisionit, ngase Sllovenia tanimë është zëvendësuar me Holandë.

Në vazhdim komisioni u pajtua që të realizoi vizitën në “Semenarna” të Lublanës me përfaqësi në Lipjanë nga e cila vizitë do të hartohet raporti me shkrim.

**Kryetari** përfundoi mbledhjen në orën 12,00 duke caktuar mbledhjen e radhës më 18.9.2007.

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryetari i Komisionit,  
**Rifat Krasniç**

